KËRKESË
Nr. 724, datë 31.1.2013

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, një kat dhe trualli, pjesë e shtëpisë së familjes Rapo me sipërfaqe 27 m^2, lagjja "Palorto", Gjirokastër.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Gjirokastër. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personin i cili preket nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për pronarin sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari që ka emrin në listën emërore, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, ka të drejtë të paraqesë pretendimet e tij të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve).

Në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik", të gjithë pronarët, të cilët do të shpronësohen pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 2 000 000 (dy milionë) lekë.

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS,
RINISË DHE SPORTEVE
Aldo Bumçi